



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

KODI I TRANSMETIMIT
PËR MEDIAT AUDIOVIZIVE DHE PLATFORMAT E SHPËRNDARJES SË
VIDEOVE

**(Miratuar me Vendimin e AMA-s nr. 60, datë 10.07.2023, ndryshuar me
Vendimin e AMA-s nr. 107, datë 11.11.2024)**



HYRJE

Kodi i Transmetimit përmban dhe përcakton parimet, rregullat, kërkesat dhe praktikën e transmetimeve audio dhe audiovizive në Republikën e Shqipërisë. Kodi i Transmetimit është hartuar në zbatim të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Struktura dhe përmbajtja e Kodit të Transmetimit mbështeten në parimet themelore të veprimtarisë së transmetimeve audio dhe audiovizive, në standardet më të arritura profesionale bashkëkohore, në normat e kërkesat morale dhe etike si edhe në praktikën e deritanishme të veprimtarisë audio dhe audiovizive në Republikën e Shqipërisë.

Ky Kod Transmetimi mban parasysh rolin e rëndësishëm të ofruesve të shërbimit mediatic audioviziv (OSHMA) si dhe platformat e shpërndarjes së videove (PSHV) si mjete të pavarura informacioni dhe platforma mediatike të zhvillimeve publike, politike e shoqërore me funksion informativ, kulturor, argëtues dhe edukativ si dhe rolin e funksionin e AMA-s si autoritet rregullator në fushën e transmetimeve audio dhe audiovizive.

Kodi i Transmetimit zbatohet nga OSHMA-të publike, private, tregtare ose jotregtare, pavarësisht formës së pronësisë mbi kapitalin, qëllimin e veprimtarisë, apo mënyrës së shpërndarjes, si tokësore, satelitore, me kablo, TV në internet, ose në ndonjë formë tjetër, si dhe qofshin kombëtarë, rajonalë, vendorë ose ndërkufitarë. Ky Kod Transmetimi zbatohet edhe nga platformat e shpërndarjes së videove.

Kodi i Transmetimit ka për qëllim të sigurojë pavarësinë dhe paanësinë e veprimtarisë së OSHMA-ve dhe PSHV-ve, duke synuar që ato të bëhen gjithnjë e më të ndërgjegjshme për përgjegjësinë e tyre kundrejt përmbajtjes së transmetimit, në përputhje me liritë dhe të drejtat themelore të njeriut, lirinë e shprehjes dhe të informimit, të drejtat dhe interesin më të lartë të fëmijës, të drejtën për privatësi dhe mbrojtje të të dhënave personale, ruajtjen e sekretit të burimeve të informacionit, moslejimin e transmetimeve që nxisin ose justifikojnë dhunën, respektimin e dinjitetit, barazisë gjinore, pluralizmit, paanësisë së informacionit, etj.

Kodi i Transmetimit u rishikua me nismën e Autoritetit të Mediave Audiovizive, autoriteti përgjegjës për hartimin dhe rishikimin e tij, bazuar në parashikimet e nenit 46 të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Varianti paraardhës i Kodit të Transmetimit ishte miratuar me Vendimin e AMA-s nr. 228, datë 11.12.2017, pasi në fushën e transmetimeve audio dhe audiovizive kishte përfunduar procesi i digjitalizimit, ishin miratuar një sërë ndryshimesh ligjore si edhe ishin evidentuar disa problematika përkitazi standardit të respektimit të të drejtave të njeriut, të cilat shtruan nevojën e reflektimit të tyre në Kodin e Transmetimit.

Rishikimi i Kodit të Transmetimit u bazua në nevojat e pasqyrimin të standardeve të reja të miratuara nga institucionet evropiane në lidhje me mediat audiovizive në kushtet e reja të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

teknologjisë, standardet e përcaktuara nga legjislacioni shqiptar, sugjerimet e institucioneve ndërkombëtare, jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe nevojën e adresimit të problemeve të dala në praktikë.

Baza ligjore mbi të cilën është rishikuar Kodi i Transmetimit është zgjeruar dhe pasuruar me aktet ndërkombëtare të detyrueshme ku shteti Shqiptar është palë, si dhe me legjislacionin rekomandues të fushës, përfshirë Direktivën 2010/13 të Bashkimit Evropian dhe Parlamentit Evropian “Për Shërbimet Mediatike Audiovizive”, e ndryshuar nga Direktiva 2018/1808 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 14 Nëntor 2018, si dhe praktikën e mira të adresimit të problemeve të shfaqura në transmetimet audio dhe audiovizive.

Transpozimi i Direktivës 2018/1808 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian të datës 14 Nëntor 2018 në ligjin 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", me ligjin 30/2023, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 97/2013 ", shtroi domosdoshmërinë e plotësimit të këtij Kodi me dispozitat, që prekin veprimtarinë e Platformave të Shpërndarjes së Videove (PSHV).

Në thelb, Kodi i Transmetimit përmban parimet bazë të transmetimit dhe rregullon veprimtarinë audio dhe audiovizive, pothuajse në të gjithë gamën e saj të shumanshme e të larmishme. Kodi është strukturuar në seksione, që përfshijnë parime e rregulla për programet informative, për mbrojtjen e fëmijëve në programet e të gjitha llojeve, për parandalimin e diskriminimit gjinor, përfshirë seksizmin, për parandalimin e gjuhës së urrejtjes, për mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, për komunikimet e ndryshme tregtare, për respektimin e dinjitetit, mbrojtjen e privatësisë dhe të dhënave personale, etj.

Gjatë rishikimit të tij, Kodi i Transmetimit u pasurua me parime dhe rregulla të reja për promovimin e barazisë gjinore, parandalimin e diskriminimit gjinor dhe luftimin e seksizmit në mediat audiovizive; parandalimin e gjuhës së urrejtjes, nxitjes së radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, mbrojtjen më të mirë të të drejtave dhe lirive të njeriut, pavarësisht statusit ose pozitës shoqërore, aksesin në median audiovizive dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Seksioni me fokus fëmijët u rishikua me qëllim përditësimin e Kodit me standardet më të larta të mbrojtjes së fëmijës, por edhe për të adresuar mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijës në të gjitha llojet e transmetimeve.

Projektkodi i Transmetimit iu nënshtrua këshillimit publik (Qershor 2022 - Mars 2023) në të gjitha qarqet e vendit me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të OSHMA-ve, organizatave të shoqërisë civile, përfaqësuesve të institucioneve në nivel qendror dhe vendor, partnerëve vendas dhe ndërkombëtarë. Gjatë kësaj periudhe, dokumenti u publikua në faqen zyrtare të AMA-s, iu përcoll me e-mail OSHMA-ve, institucioneve që në fushën e veprimtarisë së tyre kanë liritë dhe të drejtat e të gjitha grupeve shoqërore, të cilave u drejtohen transmetimet audio dhe audio vizive. Përfaqësitë e Këshillit të Evropës dhe Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë në Tiranë, të cilat e ndoqën afër të gjithë procesin, mundësuan edhe tërheqjen e mendimit të ekspertit të Këshillit të Evropës për

Projektkodin (Janar - Maj 2023). Dokumenti përfundimtar ka të reflektuar edhe vërejtjet e ekspertit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Parimet dhe rregullat e Kodit të Transmetimit zbatohen në harmoni dhe me Kodet e Sjelljes, që hartohen nga OSHMA-të dhe PSHV-të. Rishikimi i Kodeve të Sjelljes për reklamat, ushqimet dhe pijet nga çdo OSHMA është i nevojshëm me hyrjen në fuqi të këtij Kodi. Ekspertiza e AMA-s, Këshillit të Ankesave, organizatave vendase në këtë fushë, ekspertëve të pavarur të institucioneve të arsimit të lartë, që kanë në strukturat e tyre departamente të komunikimit, si edhe konsultimi me organizata dhe institucione kombëtare dhe ndërkombëtare, që veprojnë në këtë fushë kontribuojnë në kuptimin dhe zbatimin e drejtë të Kodit të Transmetimit nga ana e profesionistëve të medias.

Rregullat e Kodit të Transmetimit nuk duhet të lexohen ose të zbatohen nga OSHMA-të në mënyrë të veçuar, por në kontekstin e Kodit në tërësi, të lidhura ngushtë dhe me detajimin e tyre në rregulloret përkatëse. Gjithashtu, pavarësisht zgjerimit dhe specifikimit që ka pësuar, Kodi nuk merr përsipër të parashikojë apo sqarojë në mënyrë shteruese të gjitha rastet apo situatat. Megjithatë, parimet e ofruara në të sipas seksioneve përbërës, u mundësojnë si OSHMA-ve, ashtu edhe gjithë profesionistëve të tregut audioviziv orientim të mjaftueshëm, për të gjykuar dhe reaguar rast pas rasti konform detyrimeve të përcaktuara nga ligji nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Kodi i Transmetimit.

BAZA LIGJORE

Kodi i Transmetimit, i hartuar dhe i miratuar nga AMA, sipas detyrimit të parashikuar në nenin 46 të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, vendos rregullat, standardet dhe praktikatat e transmetimit në përputhje me përcaktimet e akteve ligjore dhe nënligjore të mëposhtme, në fuqi në Republikën e Shqipërisë:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar;
- Ligji nr.7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”
- Ligji nr. 37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të mitur”;
- Ligji nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”;
- Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 8096, datë 21.03.1996 “Për kinematografinë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9970, datë 27.7.2008 “Për barazinë gjinore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar
- Ligji nr.93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”
- Ligji nr.8528, date 23.9.1999 “Për nxitjen dhe mbrojtjen e të ushqyerit me gji”
- Ligji nr. 9518, datë 18.4.2006 “Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit”, i ndryshuar
- Ligji nr.9636, datë 6.11.2006 për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit, i ndryshuar;
- Ligji nr. 155/2015 “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9902, datë 17.4.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”.
- Ligji nr. 79/2017 “Për sportin”, i ndryshuar

2. Kodi i Transmetimit është hartuar në bazë të kërkesave që lidhen me veprimtarinë audiovizive në Bashkimin Evropian, parashikuar nga Direktiva 2010/13 e BE-së, e ndryshuar nga Direktiva (BE) 2018/1808 (Direktiva për Shërbimet e Mediave Audiovizive).
3. Kodi i Transmetimit është hartuar në zbatim të akteve ndërkombëtare për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut, ndër të cilat:
 - Karta e të Drejtave Themelore të BE-së;
 - Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Lirive Themelore, (e vitit 1998), neni 8, neni 9, neni 10, neni 14 dhe protokollin 12 i saj;
 - Konventa e OKB-së “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës” (1989);
 - Konventa e Këshillit të Evropës për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi seksual dhe abuzimi seksual (Konventa e Lazarotes);
 - Konventa e Këshillit të Evropës për krimin kibernetik dhe protokollin shtesë i saj
 - Konventa e Kombeve të Bashkuara për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racial;
 - Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit);
 - Konventa e Kombeve të Bashkuara për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara;
4. Kodi i Transmetimit është hartuar duke mbajtur parasysh, për aq sa është e mundur, rekomandimet ndërkombëtare të fushës, ndër të cilat:
 - Rekomandimi CM/Rec (2022)16 i Komitetit të Ministrave të shteteve anëtare për luftimin e gjuhës së urrejtjes;
 - Rekomandimi i përgjithshëm (2021) i GREVIO-s “Për dimensionin digjital të dhunës kundër grave;
 - Rekomandimi (2019)1 i Komitetit të Ministrave të vendeve anëtare të Këshillit të Evropës CM/Rec (2019) për parandalimin dhe luftimin e seksizmit;
 - Rekomandimi Rec (2007)17 i Komitetit të Ministrave të shteteve anëtare për standardet dhe mekanizmat e barazisë gjinore;
 - Rekomandimi Rec (2017)9 i Komitetit të Ministrave të shteteve anëtare mbi barazinë gjinore në sektorin e medias audiovizive.
 - Rekomandimi i Politikës së Përgjithshme të ECRIT (2015) 15 “Mbi luftimin e gjuhës së urrejtjes”;

- Rekomandimi 165(2004) i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës “Për të drejtën e përgjigjes në mjedisin e ri të medias;
- Rekomandimi R (90) 4 i Komitetit të Ministrave të shteteve anëtare për eliminimin e seksizmit nga gjuha.

Strategjitë dhe planet kombëtare

- Strategjia Kombëtare për barazinë gjinore 2021-2030;
- Plani Kombëtar i Veprimit për personat me aftësi të kufizuara (2021- 2025);
- Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijës (2021-2026);
- Plani Kombëtar i Veprimit për personat LGBTI (2021-2027);
- Strategjia ndërsektoriale për drejtësinë e të miturve dhe Plani i tij i Veprimit 2022-2026.

PËRKUFIZIME

Termet e mëposhtëm kanë këto kuptime në Kodin e Transmetimit:

1. “Barazi gjinore” është pjesëmarrja e barabartë e femrave dhe e meshkujve në të gjithat fushat e jetës, pozita e barabartë ndërmjet tyre, mundësi e shanse të barabarta, për të gëzuar të drejtat dhe për të përmbushur detyrimet në shoqëri, duke përfituar njëlloj nga arritjet e zhvillimit të saj.
2. “Denigrim” nënkupton sulmin ndaj kapacitetit, personalitetit ose reputacionit të një ose më shumë personave në lidhje me anëtarësimin e tyre në një grup të caktuar personash.
3. “Diskriminim” nënkupton çdo trajtim të ndryshëm mbi bazën e shkaqeve si "raca", ngjyra, gjuha, feja, përkatësia kombëtare ose etnike si edhe prejardhja prindërore, besimi, seksi, gjinia, identiteti gjinor, orientimi seksual, statusi ose karakteristika të tjera, që nuk kanë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm.
4. “Diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar” nënkupton çdo dallim, përjashtim ose kufizim për shkak të aftësisë së kufizuar, që ka si qëllim ose ndikon në pengimin ose mohimin e njohjes, gëzimit ose ushtrimit, njësoj si gjithë të tjerët, të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në fushën politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, civile dhe çdo fushë tjetër. Në këtë përkufizim përfshihen të gjitha format e diskriminimit, përfshirë edhe mohimin e përshtatjes brenda logjikës.
5. “Diskriminim për shkak të gjinisë” është çdo dallim, përjashtim ose kufizim mbi baza gjinore, që ka për qëllim ose për pasojë dëmtimin, mos-njohjen, mos-gëzimin dhe mos-ushtrimin, në mënyrë të

barabartë, nga secila gjini, të të drejtave të njeriut dhe lirive të parashikuara në Kushtetutë dhe në ligje, në fushat politike, ekonomike, shoqërore, kulturore e civile.

6. “Dhuna me bazë gjinore” është dhuna ndaj një personi për shkak të gjinisë së tij ose të saj dhe pritshmërive ndaj rolit të tij ose të saj në shoqëri ose kulturë.
7. “Dhunë ndaj gruas” është çfarëdo akti i dhunës me bazë gjinore, që shpie ose ka gjasa të shpjerë drejt vuajtjes ose dëmit psikologjik, seksual ose fizik të grave, duke përfshirë kërcënimet për këto akte, kanosjen ose mohimin e paarsyeshëm të lirisë, ose në jetën publike ose atë private.
8. “Fëmijë” është çdo person nën moshën 18 vjeç.
9. “Gjuha e urrejtjes” është çdo lloj shprehje, që nxit, promovon, përhap ose justifikon dhunën, urrejtjen ose diskriminimin ndaj një personi ose grupi personash, ose që i denigron ata, për shkak të karakteristikave ose statusit të tyre personal real ose të atribuar, bazuar në: racë, ngjyrë, gjuhë, besim, kombësi, origjinë kombëtare ose etnike, përkatësi shoqërore, moshë, paaftësi, gjini, identitet gjinor, orientim seksual si dhe çdo formë tjetër diskriminimi sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi. Gjuha e urrejtjes mund të marrë formën e fjalëve të shkruara ose të shqiptuara, ose forma të tjera si foto, imazhe, shenja, simbole, muzikë, vepër skenike ose video.
10. “Identiteti gjinor” është mënyra, se si një person ndihet dhe e shpreh gjininë e tij nëpërmjet veshjes, sjelljes dhe pamjes personale.
11. “Interesi më i lartë i fëmijës” është e drejta e fëmijës për të pasur një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e shoqëror si dhe për të gëzuar një jetë familjare e shoqërore të përshtatshme për të.
12. “Interesi publik” përfshin, por nuk kufizohet vetëm në:
 - a) zbulimin ose ekspozimin e veprës penale ose të padrejtësisë serioze;
 - b) çështjet që përbëjnë shqetësim urgjent dhe të menjëhershëm për shëndetin dhe sigurinë publike;
 - c) gjetjen, parandalimin dhe publikimin e krimeve të rënda, skandaleve dhe abuzimeve të pushtetit;
 - d) mbrojtjen e publikut nga rreziku i çorientimit/manipulimit të rëndë;
 - e) parandalimin e publikut nga mashtrimi me veprim ose deklaratë të një individi apo organizate;
 - f) garantimin e aksesit në informacione, që lehtësojnë formimin e opinionit të qytetarëve për çështjet politike, ekonomike dhe shoqërore.

13. “Këshilli i Ankesave” është struktura e ngarkuar me mbikëqyrjen e respektimit të Kodit të Transmetimit, sipas përcaktimeve të nenit 20 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
14. “Komunitet me aftësi të kufizuara dëgjimi dhe shikimi” është komuniteti me mangësi të pjesshme ose të plotë shikimi ose dëgjimi, aftësia e të cilëve për të perceptuar sinjale audio apo audiovizive është e kufizuar në atë masë, që bën të pamundur gëzimin e së drejtës së informimit.
15. “Komunikim tregtar audioviziv” është mesazh me zë ose imazh me ose pa zë, që është krijuar për të promovuar, drejtpërdrejt ose jo, mallrat, shërbimet ose imazhin e subjekteve, që kryejnë një aktivitet ekonomik. Ai shoqërohet ose përfshihet në një program, ose video të krijuar nga përdoruesi kundrejt pagesës ose shpërblimit të ngjashëm përkatës apo për qëllime vetëpromovuese. Format e komunikimeve audiovizive me natyrë tregtare janë:
 - a) reklamat në shërbimet audiovizive;
 - b) sponsorizimet;
 - c) shitjet e drejtpërdrejta;
 - ç) dritaret e teleshitjeve;
 - d) vendosja e produkteve në programe.
16. “Pornografi” është përshkrimi i qartë i organeve seksuale ose marrëdhënieve seksuale, pa ndonjë justifikim të veçantë të lidhur me programin ose për qëllime artistike.
17. “Përmbajtje me natyrë seksuale” është përmbajtje jo e përshtatshme për të miturit nën moshën 18 vjeç, duke përfshirë, por pa u kufizuar në:
 - a) paraqitjet e dhunës së rëndë dhe pasojave të rënda të dhunës dhe/ose përshkrimi i qartë i skenave të dhunës seksuale;
 - b) përshkrime të detajuara të aktiviteteve seksuale në përmbajtje, qëllimi kryesor i të cilave nuk është të rrisin stimulimin seksual të audiencës;
 - c) Përmbajtje, qëllimi kryesor i të cilës, është të rrisë stimulimin seksual të audiencës dhe që tregon lakuriqësi në pozicione seksuale joshëse, provokuese, pa portretizuar në mënyrë të qartë organet seksuale gjatë marrëdhënies seksuale;
 - d) Përmbajtje në të cilën përdoren shpesh fyerje të ashpra dhe/ose shprehje vulgare.
18. “Përmbajtje e dëmshme për fëmijët” është çdo pamje, imazh ose material, që mund të dëmtojë zhvillimin fizik, mendor ose moral të fëmijëve nëpërmjet shërbimeve të medias audio, audiovizive dhe internetit.
19. “Përgjegjësi editoriale” është ushtrimi i kontrollit efektiv mbi përzgjedhjen e programeve dhe organizimin e tyre
 - në një listë dhe orar, në rastin e shërbimeve të transmetimit të drejtpërdrejtë audio dhe audioviziv

- në një katalog, në rastin e shërbimeve të programit audioviziv, sipas kërkesës.
20. “Program radio” është tërësia e mesazheve audio, që përbëjnë një element individual brenda një liste apo katalogu të krijuar nga ofruesi i shërbimit, forma dhe përmbajtja e të cilit janë të krahasueshme me formën dhe përmbajtjen e transmetimit radio.
 21. “Program” është një seri imazhesh lëvizëse, me ose pa zë, që - pavarësisht nga kohëzgjatja - përbëjnë një element individual, brenda një liste ose katalogu të krijuar nga një ofrues i shërbimit, forma dhe përmbajtja e të cilit janë të krahasueshme me formën dhe përmbajtjen e transmetimit televiziv, përfshirë debate në studio dhe në terren, filma artistikë, dokumentarë dhe vizatimorë me metrazh të ndryshëm, ngjarje sportive, spektakle realiteti, spektakle teatrore, muzikore apo me kukulla, videoklipe, variete, programe për fëmijë dhe dramat origjinale.
 22. “Radikalizim” është procesi i brendësimit të qasjeve ekstreme politike, fetare ose shoqërore, të cilat bien në kundërshtim me vlerat e një shoqërie demokratike.
 23. “Racizëm” është besimi se motive, si "raca", ngjyra, gjuha, besimi fetar, shtetësia, origjina etnike ose kombëtare, justifikojnë përbuzjen ndaj një personi ose kategorie dhe/ose superioritetin e një personi ose të një kategorie.
 24. “Reklamë” është çdo formë e publikimit të transmetuar kundrejt pagesës ose përfitimeve të tjera nga një sipërmarrje publike ose private apo nga një person për qëllime vetreklamuese, lidhur me veprimtari tregtare e fitimprurëse, veprimtari profesionale ose ekspertizë si dhe për mbështetjen e pajisjes me mallra ose shërbime, përfshirë këtu pasuri të paluajtshme, të drejta e detyrime të tjera, përkundrejt pagesës.
 25. “Seksizëm” është çdo akt, veprim, gjest, përfaqësim vizual, fjalë të shkruara ose të thëna në median audio dhe audiovizive, praktika ose sjellje të bazuara në idenë se një person ose një grup personash është inferior për shkak të gjinisë, që ndodh në sferën publike ose private, online ose offline, me efekt dhe qëllim dhunimin e dinjitetit të njeriut, të drejtat dhe liritë themelore të një personi apo grupi personash, shtetas shqiptarë, të huaj apo pa shtetësi, që rezulton në dëm ose vuajtje fizike, seksuale, psikologjike ose socio-ekonomike ndaj një personi apo një grupi personash, shtetas shqiptarë, të huaj apo pa shtetësi ose që krijon apo ushqen krijimin e një mjedisi frikësues, armiqësor, degradues, fyes ose poshtërues ose ushqen apo synon ruajtjen dhe përforcimin e stereotipeve gjinore.
 26. “Stigmatizim” nënkupton etiketimin e një grupi personash në një mënyrë negative.
 27. “Stereotip gjinor” është paragjykimi, sipas të cilit femrave dhe meshkujve u paracaktohen në mënyrë arbitrare karakteristika dhe role të kufizuara sipas gjinisë.
 28. “Shprehja” përfshin fjalë dhe publikime të çfarëdo forme, përfshirë edhe ato përmes medias elektronike, si edhe përhapjen dhe ruajtjen e tyre. “Shprehja” përfshin gjithashtu edhe përdorimin e

sjelljes - si p.sh. gjesteve - për të komunikuar një ide, mesazh ose mendim apo formave të tjera si foto, imazhe, shenja, simbole, muzikë, vepër skenike ose video.

29. “Ofrues shërbimi mediatik audioviziv (OSHMA)” është personi fizik ose juridik, që ka përgjegjësinë editoriale për zgjedhjen e përmbajtjes së shërbimeve të transmetimit audioviziv dhe që vendos mënyrën e organizimit të saj.
30. “Ofruesi i platformës së shpërndarjes së videove” është personi fizik ose juridik, i cili ofron shërbimin e platformës së shpërndarjes së videove.
31. “Shërbimi mediatik audioviziv” është një shërbim, qëllimi kryesor i të cilit ose i një seksioni të shkëputur të tij i kushtohet ofrimit të programeve, nën përgjegjësinë editoriale të një ofruesi të shërbimit mediatik, për publikun e gjerë, për të informuar, argëtuar ose edukuar, nëpërmjet rrjeteve të komunikimeve elektronike. Një shërbim i tillë mediatik audioviziv është një transmetim televiziv ose një shërbim mediatik audioviziv, sipas kërkesës dhe/ose një komunikim tregtar audioviziv, sipas përcaktimeve të legjisllacionit në fuqi për median audiovizive.
32. “Shërbimi i platformës së shpërndarjes së videove” nënkupton një shërbim, qëllimi kryesor i të cilit ose i një pjese të shkëputur të tij, apo një funksion thelbësor i shërbimit është ofrimi për publikun e gjerë të programeve, videove të krijuara nga përdoruesi ose të dyjave së bashku, me qëllim informimin, argëtimin ose edukimin nëpërmjet një rrjeti të komunikimeve elektronike për të cilat ofruesi i platformës së shpërndarjes së videove nuk ka përgjegjësi editoriale, dhe organizimi i të cilës, përfshirë përdorimin e mjeteve automatike ose algoritmet në veçanti për shfaqjen, etiketimin dhe renditjen, përcaktohet nga vetë ofruesi i platformës së shpërndarjes së videove.
33. “Parimi i drejtësisë” është garantimi nga ana e OSHMA-ve e shmangies së padrejtësive dhe trajtimit të padrejtë të individëve, komuniteteve dhe organizatave në transmetimet audio dhe audiovizive.
34. “Video e krijuar nga përdoruesi” është një grup imazhesh lëvizëse me ose pa zë, që përbëjnë një element individual, pavarësisht nga gjatësia e tij, që krijohet nga një përdorues dhe ngarkohet në një platformë për shpërndarjen e videove nga ai përdorues ose çdo përdorues tjetër.

Përkufizimet e tjera në Kodin e Transmetimit kanë të njëjtin kuptim si në ligjin nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

SEKSIONI 1

PARIMET THEMELORE

Parimet themelore që përbëjnë bazën e zhvillimit të veprimtarisë audio dhe audiovizive, e cila mbështetet në garantimin e lirisë dhe pluralizmit të mjeteve të komunikimit audio dhe audioviziv janë si më poshtë vijon:

- 1.1 Operatorët e shërbimit mediatic audioviziv dhe platformat e shpërndarjes së videove, gjatë zhvillimit të veprimtarisë së tyre respektojnë, garantojnë dhe promovojnë liritë dhe të drejtat e njeriut, lirinë e shprehjes, të drejtën e informimit, parimin e mosdiskriminimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale.
- 1.2 Veprimtaria e transmetimeve audio dhe audiovizive respekton rendin kushtetues, sovranitetin dhe integritetin kombëtar.
- 1.3 Veprimtaria e transmetimeve audio dhe audiovizive është e lirë, respekton paanshmërisht të drejtën për informacion, bindjet politike e besimet fetare, personalitetin, dinjitetin, normat morale dhe etike të shoqërisë si dhe kërkesat e deontologjisë së profesionit. Operatorët e shërbimit mediatic audioviziv si dhe platformat e shpërndarjes së videove janë të hapur ndaj ideve, opinionëve, tendencave e kaheve të ndryshme politike, shoqërore, kulturore e fetare.
- 1.4 Veprimtaria e transmetimeve audio dhe audiovizive respekton, mbron dhe promovon të drejtat e fëmijës, mirëqenien, shëndetin, zhvillimin harmonik moral dhe fizik të tij. Parimi i interesit më të lartë të fëmijës duhet të jetë parësor në çdo vendimmarrje për programimin, transmetimin, informimin e tyre dhe informacionet për ta.
- 1.5 Transmetimet audio dhe audiovizive, që përmbajnë elementë të pornografisë ose dhunës së skajshme, duhet t'u nënshtrohen rregullave të veçanta të një sistemi kontrolli, si ai i aksesit të kushtëzuar ose programeve të krijuara.
- 1.6 Në transmetimet audio dhe audiovizive nuk duhet të përdoren shprehje, që përmbajnë gjuhë urrejtje, denigrim ose stigmatizim kundër një personi ose grupi personash, nuk duhet të përdoret gjuhë që promovon, nxit ose justifikon dhunën ndërmjet shtetasve në përgjithësi, dhunën me bazë gjinore në veçanti, radikalizmin, ekstremizmin dhe terrorizmin ose që nxit urrejtjen e grindjet për shkak të kombësisë, etnisë, besimit fetar, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual. Në transmetimet audio dhe audiovizive duhet të merren të gjitha masat e nevojshme për të ndaluar, kundërvepruar, kundërshtuar dhe hedhur poshtë çdo shprehje të tillë.
- 1.7 Veprimtaria e transmetimeve audio dhe audiovizive respekton dhe promovon të drejtat dhe lirinë e personave me aftësi të kufizuara, veçanërisht të *personave me aftësi të kufizuara*

dëgjimi dhe shikimi, për të kërkuar, pasur dhe shpërndarë informacion dhe ide, përmes të gjitha formave të komunikimit dhe teknologjisë së aksesueshme dhe të përshtatshme për lloje të ndryshme të aftësisë së kufizuar, në kohën e duhur, pa kosto shtesë si edhe në mënyrë progresive drejt një situatë ku ata i gëzojnë këto të drejta në baza të barabarta me pjesëtarët e tjerë të shoqërisë.

- 1.8 Veprimtaria e transmetimeve audio dhe audiovizive siguron informim objektiv dhe të paanshëm të publikut, duke paraqitur në mënyrë të saktë faktet dhe ngjarjet si edhe duke respektuar formimin e lirë të opinionit.
- 1.9 OSHMA-të nuk duhet të manipulojnë ose të çorientojnë qëllimisht audiencën nëpërmjet keqpërdorimit ose keqinterpretimit të deklaratave të bëra në kontekste të caktuara.
- 1.10 Në transmetimet audio dhe audiovizive respektohen të drejtat e transmetimit, të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to.
- 1.11 Në të gjitha llojet e transmetimeve audio dhe audiovizive respektohet standardi letrar i gjuhës shqipe.
- 1.12 Transmetimet audio dhe audiovizive respektojnë privatësinë, të dhënat personale dhe garantojnë të drejtën e përgjigjes.
- 1.13 Transmetimet audio dhe audiovizive realizojnë larmi përmbajtjeje dhe informacioni, duke respektuar lirinë e konkurrencës dhe shfrytëzuar mundësitë e zhvillimit teknologjik.
- 1.14 Veprimtaria e transmetimeve audio dhe audiovizive garanton të drejtën e çdo shtetasi për të marrë shërbime të transmetimeve audio dhe/ose audiovizive, të ofruara për publikun nga operatorët e shërbimeve audio dhe audiovizive, që e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- 1.15 OSHMA-të dhe PSHV-të respektojnë fqinjësinë e mirë midis popujve. Transmetimet audio dhe audiovizive ruajnë, zhvillojnë dhe promovojnë shumëllojshmërinë kulturore, veçanërisht kulturën, identitetin, traditat, trashëgiminë kulturore, artistike e mjedisore të pakicave kombëtare, në nivel kombëtar dhe vendor.
- 1.16 Transmetimet audio dhe audiovizive promovojnë kulturën e tolerancës, dialogut dhe mosdiskriminimit, përforcojnë mesazhet pozitive, respektin e ndërsjellë, mirëkuptimin dhe bashkëpunimin pa dallim mbi bazën e identitetit etnik, kulturor, gjuhësor ose fetar.

SEKSIONI 2

E DREJTA PËR PRIVATËSI DHE MBROJTJE TË TË DHËNAVE PERSONALE

- 2.1 OSHMA-të dhe PSHV-të respektojnë jetën private dhe familjare, shtëpinë, shëndetin dhe korrespondencën e çdo personi.
- 2.2 OSHMA-të respektojnë të drejtën e çdo personi për të mbrojtur të dhënat e tij personale gjatë përpunimit të tyre për qëllime gazetareske, letrare ose artistike.
- 2.3 Shpërndarja e informacionit te publiku, përfshirë fotografi apo pamje nga jeta private pa pëlqimin e personit të prekur, është e pranueshme vetëm nëse interesi publik tejkalon të drejtën e tij për privatësi dhe/ose mbrojtjen e të dhënave personale.
- 2.4 Përpunimi dhe publikimi i të dhënave personale të një personi duhet të lidhen me qëllimin për të cilin ato përpunohen dhe publikohen dhe të mos e tejkalojnë atë përgjatë pasqyrit të çështjes.
- 2.5 Gjatë transmetimit, gazetari duhet të sigurohet që informacioni të jetë i saktë, i paraqitur në mënyrë të drejtë dhe objektive, veçanërisht kur përfshin zbulimin e aspekteve të jetës private ose të të dhënave personale të një personi.
- 2.6 Përfshirja në jetën publike nuk e përjashton personin nga e drejta për privatësi, përveç rasteve kur rrethanat private ndikojnë në performancën ose në përshtatjen e tij me rolet publike që mban ose kërkon.
- 2.7 Identifikimi i drejtpërdrejtë ose rastësor i një biznesi ose një personi gjatë mbulimit të një ngjarjeje përligjet vetëm me interesin publik. Gjatë dokumentimit të fakteve të kronikës, të cilat ndodhin në vende publike, tregohet kujdes të shmanget fokusimi te personi/at ose detajet e tij/tyre, nëse publikimi i këtyre pamjeve nuk ka lidhje ose tejkalon qëllimin e kronikës dhe/ose deontologjinë e profesionit të gazetarit.
- 2.8 Përveç rasteve me interes të lartë publik, OSHMA-të nuk duhet të transmetojnë imazhe ose fotografi të personit të arrestuar në pranga, pa pëlqimin paraprak të tij.
- 2.9 OSHMA-të nuk bëjnë publik identitetin e personit që ka humbur jetën ose është përfshirë në aksident, përveç rasteve kur është konfirmuar paraprakisht, se pjesëtarët e familjes janë të informuar dhe të vetëdijshëm për situatën ose kur identiteti i viktimës është vendimtar për hetimin. Rastet përjashtimore dikton vetëm nga interesi publik.
- 2.10 OSHMA-të duhet të respektojnë të drejtën e personit për privatësi kur raportojnë për grupet e pambrojtura të popullatës ose për situata sëmundjeje, fatkeqësie ose tragjedi. Gazetari duhet

të shmangë çdo formë ngacmimi, ndërhyrjeje të lirë, spekulimi dhe ekspozimi të pajustificuar, që mund të rrisë dhimbjen dhe shqetësimin e personit ose personave të përfshirë.

- 2.11 OSHMA-të duhet të respektojnë parimin e prezumimit të pafajësisë, derisa personi të jetë dënuar me një vendim të formës së prerë. Kjo nuk duhet të pengojë OSHMA-të të raportojnë profesionalisht duke respektuar parimin e prezumimit të pafajësisë për çështjet me interes publik.
- “Interesi publik” përfshin, por nuk kufizohet vetëm në:
- g) zbulimin ose ekspozimin e veprës penale ose të padrejtësisë serioze;
 - h) çështjet që përbëjnë shqetësim urgjent dhe të menjëhershëm për shëndetin dhe sigurinë publike;
 - i) gjetjen, parandalimin dhe publikimin e krimeve të rënda, skandaleve dhe abuzimeve të pushtetit;
 - j) mbrojtjen e publikut nga rreziku i çorientimit/manipulimit të rëndë;
 - k) parandalimin e publikut nga mashtrimi me veprim ose deklaratë të një individi apo organizate;
 - l) garantimin e aksesit në informacione, që lehtësojnë formimin e opinionit të qytetarëve për çështjet politike, ekonomike dhe shoqërore.
- 2.12. OSHMA-të respektojnë të drejtën e privatësisë kur japin të dhëna e informacione në lidhje me personin e dyshuar apo akuzuar si edhe për subjekte të tjerë, të lidhur me të në proces gjyqësor.
- 2.13 OSHMA-të, gjatë raportimit të një krimi, shmangin identifikimin e të afërmeve ose të njohurve të personit të akuzuar ose dënuar pa pëlqimin e tyre paraprak, përveç rasteve kur kjo kontribuon në zbardhjen e çështjes.
- 2.14 OSHMA-të nuk duhet të zbulojnë identitetin e dëshmitarëve, me përjashtim të rasteve kur këta persona kanë dhënë më parë pëlqimin e tyre, kur identifikimi i dëshmitarëve ka interes publik, ose kur dëshmia është bërë publike më parë. OSHMA-të nuk zbulojnë identitetin e dëshmitarit, kur një gjë e tillë mund të vërë në rrezik jetën ose sigurinë e tij.
- 2.15 Gazetarët raportojnë për personat që po kryejnë dënimin me burgim, pa penguar mirëfunksionimin e sistemit të drejtësisë, duke respektuar të drejtat e të dënuarve, privatësinë e personelit të burgut dhe sigurinë e institucionit të ekzekutimit të dënimit.
- 2.16 OSHMA-të tregojnë kujdes në publikimin e pamjeve që dokumentojnë veprimet e ndalimit, shoqërimit ose arrestimit të një personi, me qëllim mos-cenimin e dinjitetit të tij. Pamjet dhe fotot mund të përdoren në mënyrë të ligjshme dhe të përhapen vetëm për të dhënë thelbin e informacionit në lidhje me lajmin që transmetohet duke përdorur teknikën e nevojshme të mbulimit të identitetit.

- 2.17 OSHMA-të tregojnë kujdes në rastet e transmetimit të informacioneve në lidhje me një krim ose aksident, duke verifikuar paraprakisht dhe me kujdes emrin e viktimës/viktimave dhe pamjet e vendngjarjes, për të shmangur fokusimin e vëmendjes së publikut te viktima dhe të afërmit e saj.
- 2.18 OMSHA-të mbrojnë të dhënat shëndetësore dhe të dhënat e tjera sensitive të personave në të gjitha llojet e formateve audio dhe audiovizive dhe shmangin publikimin e detajeve të panevojshme.
- 2.19 Gazetarët nuk japin të dhëna në lidhje me identitetin gjinor, orientimin seksual, të dhëna të tjera të jetës seksuale të një personi dhe nuk publikojnë imazhet "para" dhe "pas" të personave interseks pa pëlqimin e tyre paraprak ose nëse ato nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me qëllimin e programit. Përpara intervistimit, gazetari pyet të ftuarin/ftuarën, për mënyrën, se si ai/ajo preferon t'i drejtohet.
- 2.20 OSHMA-të shmangin publikimin e detajeve identifikuese për personat LGBTI+ si vendi i punës, vendbanimi, shkolla ose të bëjnë përshkrime që në mënyrë të tërthortë e identifikojnë atë, pa pëlqimin e tyre.
- 2.21 OSHMA-të përdorin mbulimin e pamjes së një personi ose modifikimin e zërit të tij kur intervistojnë persona të dënuar, për çështje që lidhen me dhunën në familje, seksualitetin, orientimin seksual, identitetin gjinor.
- 2.23 OSHMA-të nuk duhet të përdorin fotografi ose imazhe të personave LGBTI+ pa lejen e tyre. Nëse ka interes publik, merren masa që paraqitja e imazheve pa lejen e personit të mos e vëre atë në rrezik.
- 2.24 OSHMA-të bëjnë kujdes gjatë intervistimit të personit LGBTI+ për të mos ushtruar presion, në mënyrë që ai/ajo të tregojë historinë e jetës së vet ose të identifikojë familjen e vet. OSHMA-të bëjnë kujdes kur pasqyrojnë ngjarje me përfshirjen e personave LGBTI+, duke shmangur komentet homofobe/transfobe dhe të dhënat identifikuese në rastet e pasqyrit të shërbimeve mbështetëse që merr viktima LGBTI+.
- 2.25 OSHMA-të respektojnë legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe udhëzimet e miratuara nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, të zbatueshme në përpunimin e të dhënave personale për qëllime gazetareske, letrare ose artistike. Të dhënat e arkivuara prej OSHMA-ve aksesohen, modifikohen dhe fshihen përputhur me kërkesat ligjore. OSHMA-të lejohen të mbajnë të dhëna të tilla për qëllime historike, si pjesë e të dhënave të tyre të transmetimit si edhe për raportimin e çështjeve me interes publik.

- 2.26 Në rastet e ankesave lidhur me cenimin e privatësisë së individit, OSHMA-ja përgjegjëse merr në trajtim ankesën. Në rast refuzimi, Këshilli i Ankesave i shqyrton ato në përputhje me legjislacionin në fuqi për mediat audio dhe audiovizive.

SEKSIONI 3

TRANSMETIMI I PROGRAMEVE INFORMATIVE

Veprimtaria informative audio dhe audiovizive, pavarësisht nga profili i operatorit të shërbimit mediatik audioviziv që e ushtron, përbën në të gjitha rastet një shërbim me interes të përgjithshëm publik dhe zhvillohet në zbatim e në përputhje me parimet e kërkesat që vijojnë:

- 3.1. OSHMA-të, gjatë veprimtarisë së tyre informative, respektojnë lirinë e shprehjes dhe të informacionit në kuadrin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të parashikuara në Kushtetutë, aktet ligjore ndërkombëtare, legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë si dhe standardet e hartuara nga institucionet dhe organizatat ndërkombëtare, që zhvillojnë aktivitetin në këtë fushë.
- 3.2. OSHMA-të ushtrojnë veprimtarinë e tyre informative në përputhje me parimet e parashikuara nga Kushtetuta, legjislacioni në fuqi dhe rregullat e parashikuara në këtë Kod.
- 3.3. Informacioni i transmetuar duhet të jetë i vërtetë, i saktë, i balancuar dhe i verifikuar. Në rast se konstatohet një pasaktësi në informacionin e transmetuar, një deklaratë jo e vërtetë ose një shtrembërim i një fakti të njohur, OSHMA e korrigjon atë pa vonesa të paarsyeshme në të njëjtin standard ofrimi.
- 3.4 Informacioni i transmetuar respekton pluralizmin, diversitetin e mendimeve dhe formimin e lirë të opinionit.
- 3.5 Të gjitha lajmet ofrohen në mënyrë objektive dhe të paanshme.
- 3.6 Profesionistët e mediave audio dhe audiovizive kanë të drejtë të ruajnë fshehtësinë e burimeve të informacionit, me përjashtim të rastit kur gjykata vendos për publikimin e burimit të informacionit.
- 3.7 OSHMA-të nuk duhet të transmetojnë lajme, që cenojnë rregullat e etikës dhe moralit publik si edhe lajme, që mund të nxisin vepra penale, urrejtje ose qëndrime, që cenojnë rendin kushtetues, sovranitetin dhe integritetin kombëtar.
- 3.8 Transmetimet audio dhe audiovizive informative nuk duhet të përmbajnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të nënkuptuar mesazhe diskriminuese për shkaqe si: gjinia, raca, mosha, ngjyra, etnia, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike,

gjendja ekonomike, arsimore ose shoqërore apo për çdo shkak tjetër, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

- 3.9 OSHMA-të, në programet informative, nuk promovojnë për qëllime sensacionale, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë dhunën, nuk transmetojnë pamje, thirrje për urrejtje apo mesazhe ekstremiste, nuk përdorin gjuhë sensacionale, provokuese ose stigmatizuese.
- 3.10 OSHMA-të tregojnë kujdes në respektimin e të drejtave të fëmijëve viktime të krimit, përfshirë viktimat e krimit në familje, kur raportojnë rastet në të cilat fëmijët janë viktime ose autorë të bullizmit, dhunës seksuale dhe veprave penale të tjera penale.
- 3.11 OSHMA-të nuk lejohen të transmetojnë programe që shfaqin, komunikojnë ose nxisin te fëmijët sjellje të dhunshme, pornografike, të papërshtatshme për moshën, pjesëmarrjen e tyre në konflikte etj.
- 3.12 OSHMA-të nuk duhet të ofrojnë imazhe dramatike dhe të shtrembëruara të sëmundjeve mendore në programet informative dhe argëtuese, nuk duhet të paraqesin modele që nxisin reagime negative ndaj personave me probleme të shëndetit mendor, përfshirë frikën, refuzimin, stigmën dhe diskriminimin e tyre.
- 3.13 OSHMA-të mbrojnë dhe promovojnë shëndetin mendor, kontribuojnë në informimin për rëndësinë e zbulimit të hershëm të problemeve të shëndetit mendor, me synim parandalimin dhe luftimin e paragjykimeve publike dhe pranimin shoqëror të tyre, luftojnë diskriminimin dhe stigmën në mjedisin shoqëror si dhe promovojnë modele pozitive njerëzish, që jetojnë me sëmundje mendore.
- 3.14 OSHMA-të nuk duhet të publikojnë të dhëna konfidenciale për shkak të gjendjes shëndetësore të personave me aftësi të kufizuara, përfshirë probleme të shëndetit mendor.
- 3.15 OSHMA-të duhet të udhëhiqen nga standardet e gjithëpranuara ndërkombëtare të raportimit ose pasqyrimin në programeve informuese të problematikave të shëndetit mendor, vetëvrasjeve, etj., të cilat mund të jenë shqetësuese për publikun ose mund të ushtrojnë ndikim te personat e prekur prej tyre në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë. OSHMA-të inkurajohen të përfshijnë në kodet e sjelljes rregulla më të detajuara lidhur me raportimin dhe trajtimin e rasteve të tilla.
- 3.16 OSHMA-të kujdesen të marrin masa paralajmëruese, të artikuluar edhe verbalisht përpara transmetimit të një materiali, që, duke pasur parasysh tematikën dhe audiencën e mundshme të programit, mund të shqetësojë ose të ofendojë seriozisht një numër të konsiderueshëm shikuesish.
- 3.17 OSHMA-të nuk e keqpërdorin në përmbajtje, procedura dhe formë aksesin e tyre në informacion. Informacioni mblidhet në mënyrë etike dhe ligjore si edhe përcillet me kulturë profesionale e gjuhësore, duke shmangur shpërdorimin.

- 3.18 OSHMA-të mbajnë në konsideratë ndjeshmërinë e publikut në rastet e fatkeqësive, katastrofave, aksidenteve, duke u dhënë përparësi operacioneve të shpëtimit dhe mbështetjes. Media duhet të tregojë maturi me fotot, videot amatore ose pamjet e katastrofave, aksidenteve ose dhunës, duke respektuar dinjitetin e të ekspozuarve dhe ndjeshmërinë e të afërmeve.
- 3.19 Informacioni që transmetohet, nuk mund të përdoret për përfitime personale ose përfitime të tjera të pronarëve, drejtuesve apo gazetarëve të mediave audio dhe/ose audiovizive.
- 3.20 OSHMA-të duhet të informojnë audiencën për zhvillimet aktuale në lidhje me çështjet mjedisore, shëndetin dhe informacione të tjera shkencore në një mënyrë që i jep peshën e duhur balancës së njohurive shkencore bashkëkohore.
- 3.21 Informacioni shkencor, të dhënat, testet, anketat, rezultatet e kërkimit ose citimet nga literatura teknike dhe shkencore nuk duhet të paraqiten në mënyrë çorientuese ose manipuluese.
- 3.22 OSHMA-të shmangin promovimin e padrejtë, gjatë transmetimit të komunikimeve me natyrë tregtare për mallrat si edhe respektojnë parimin e proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit duke mos favorizuar shoqëri të veçanta tregtare ose subjekte tregtare, të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me ortakët apo aksionarët e shoqërive audio dhe/ose audiovizive.
- 3.23 OSHMA-të kanë detyrimin të publikojnë përgjigjen ose korigjimin në rast se reputacioni i një personi është prekur drejtpërdrejt nga publikimi i informacionit të pavërtetë faktik ose të pasaktë, por jo për gjykimet vlerësuese dhe mendimet kritike. Gjykimet vlerësuese, të cilat janë opinione dhe nuk mund të vërtetohen si të vërteta apo të rreme nëpërmjet provave objektive, nuk çojnë në të drejtën për përgjigje. Mendimet kritike nuk përfshihen tek e drejta e përgjigjes.
- 3.24 OSHMA-të ofrojnë të drejtën e përgjigjes, publike dhe pa pagesë, si formë reagimi ndaj çdo informacioni të publikuar në media, i cili paraqet fakte të pasakta për individin dhe cenon të drejtat e tij/saj personale. E drejta e përgjigjes duhet të aplikohet brenda afateve që parashikon ligji organik.

SEKSIONI 4

FËMIJËT NË TRANSMETIMET AUDIO DHE AUDIOVIZIVE DHE PLATFORMAT E SHPËRNDARJES SË VIDEOVE

- 4.1 Transmetimet audio dhe audiovizive për fëmijët udhëhiqen nga interesi më i lartë i fëmijës. Interesi më i lartë i fëmijës është parësor në çdo veprim të OSHMA-ve që përfshin fëmijën apo i drejtohet fëmijës.
- 4.2 OSHMA-të trajtojnë me respekt, dinjitet dhe profesionalizëm të gjithë fëmijët që marrin pjesë në programet audio dhe audiovizive.

- 4.3 OSHMA-të dhe PSHV-të garantojnë respektimin e dinjitetit, nderit dhe personalitetit të fëmijës. Fëmija mbrohet nga diskriminimi, për shkaqe, si: raca, ngjyra, gjinia, gjuha, besimi, origjina kombëtare, etnike ose shoqërore, aftësia e kufizuar, prejardhja familjare, orientimi seksual, identiteti gjinor ose çdo gjendje tjetër e fëmijës, prindërve ose përfaqësuesve të tij ligjorë apo i pozitës, veprimtarisë, opinionëve të shprehura ose/dhe bindjeve të prindërve, përfaqësuesve të tij ligjorë ose anëtarëve të tjerë të familjes.
- 4.4 OSHMA-të dhe PSHV-të garantojnë respektimin e jetës private, familjare, banesës, korrespondencës së fëmijës. Privatësia e fëmijës mbrohet në të gjitha situatat, me përjashtim të rasteve kur interesi më i lartë i fëmijës dikton diçka tjetër. Privatësia e fëmijës, që merr pjesë në procedurat gjyqësore ose administrative mbrohet në pasqyrimin audioviziv të këtyre procedurave, me përjashtim të rasteve kur interesi më i lartë i fëmijës dikton diçka tjetër dhe në atë masë, që i shërben këtij interesi.
- 4.5 OSHMA-të duhet të mbrojnë fëmijën nga aksesimi në materiale me përmbajtje të paligjshme ose të dëmshme në programet audio dhe audiovizive.
- 4.6 Programet audio dhe audiovizive të ofruara nga OSHMA-të, që mund të dëmtojnë zhvillimin fizik, mendor ose moral të fëmijëve, duhet të transmetohen vetëm në atë mënyrë, që siguron se fëmijët nuk do t'i dëgjojnë ose shohin ato, përmes zgjedhjes së kohës së transmetimit, përdorimit të mjeteve të verifikimit të moshës ose masave të tjera teknike.
- 4.7 OSHMA-të dhe PSHV-të nuk lejojnë përdorimin e fëmijëve me probleme patologjike ose me aftësi të kufizuara për qëllime propagandistike, përfitimi ose për çdo qëllim tjetër abuziv kundrejt të drejtave dhe dinjitetit të tyre.
- 4.8 OSHMA-të informojnë në lidhje me mirëqenien, edukimin, zhvillimin fizik dhe psikologjik të fëmijës në një gjuhë miqësore dhe të përshtatshme për të, duke mbajtur parasysh nevojat e fëmijëve, veçanërisht të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe fëmijëve që i përkasin pakicave kombëtare.
- 4.9 OSHMA-të kujdesen, që të mundësojnë të drejtën e pjesëmarrjes dhe dëgjimit të mendimit të fëmijës, të drejtën e fëmijës për të shprehur lirisht, individualisht ose në grup, pikëpamjet dhe mendimin e vet për çështje që kanë të bëjnë me fëmijët dhe mirëqenien e tyre si dhe inkurajojnë përfilljen e mendimit të fëmijës, të shfaqur në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar.

Media në shërbim të interesit më të lartë të fëmijës

- 4.10 OSHMA-të mbështesin promovimin në media të shembujve pozitivë të fëmijëve dhe për fëmijët. Ato bëjnë kujdes, të mos promovojnë direkt ose tërthorazi shembuj që ndikojnë negativisht edukimin e fëmijës.
- 4.11 OSHMA-të nuk transmetojnë programe të dëmshme për fëmijët midis orës 06:00 dhe orës 22:00.
- 4.12 OSHMA-të dhe PSHV-të në çdo rast, sigurojnë marrjen e masave për ndalimin e publikimeve me përmbajtje të paligjshme për fëmijët. Në rast të vënies në dijeni për transmetimin e një materiali me përmbajtje të paligjshme, ata marrin masa të menjëhershme për fshirjen ose bllokimin e tij.
- 4.13 OSHMA-të dhe PSHV-të marrin masa që programet audio dhe audiovizive të mos dëmtojnë zhvillimin moral, mendor e fizik të fëmijëve dhe parandalojnë aksesin e fëmijëve në programet me përmbajtje të dhunshme, pornografike apo seksuale.
- 4.14 OSHMA-të që përmbajtjen e tyre e publikojnë edhe online dhe PSHV-të, shqyrtojnë pa vonesë dhe me përparësi çdo rast të konstatuar së brendshmi gjatë veprimtarisë së vet si edhe çdo raportim nga të tretë lidhur me materiale me përmbajtje potencialisht të paligjshme apo të dëmshme për fëmijët në internet dhe marrin masat për fshirjen ose bllokimin e tyre.
- 4.15 Pjesëmarrja e fëmijës nën moshën 14 vjeç në programet audio dhe audiovizive bëhet vetëm me pëlqimin me shkrim të prindit ose kujdestarit të fëmijës, duke informuar paraprakisht ata për qëllimin e programit dhe përfshirjen e fëmijës në të.
- 4.16 OSHMA-të mundësojnë praninë e psikologut në programet audio dhe audiovizive ku marrin pjesë dhe pyeten fëmijë nën moshën 10 vjeç.
- 4.17 OSHMA-të dhe PSHV-të kujdesen të shmangin situatat ku fëmijët përdoren ose ekspozohen nga prindi, kujdestari, institucionet publike ose private për qëllime të përfitimit personal ose për të ndikuar vendimet e autoriteteve publike.
- 4.18 OSHMA-të mbrojnë privatësinë dhe të dhënat vetjake të fëmijës në të gjitha transmetimet audio dhe audiovizive. Media mbron privatësinë e fëmijës në të gjitha fazat e procedurave gjyqësore ose administrative, gjatë pasqyrit të tyre audioviziv. Raste përjashtimore ekzistojnë vetëm nëse ato i shërbejnë interesit më të lartë të fëmijës dhe në çdo rast, vetëm në atë masë që i shërbejnë këtij interesi.
- 4.19 OSHMA-të dhe PSHV-të parashikojnë në Kodin e Sjelljes standarde të detajuara për adresimin e problemeve të fëmijëve dhe mënyrën e trajtimit të fëmijëve-viktima të dhunës, abuzimit fizik,

psikologjik, seksual, trafikimit, me synim mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve gjatë transmetimeve audio dhe audiovizive.

- 4.20 OSHMA-të mundësojnë shtimin e programeve për fëmijë dhe përmirësimin e cilësisë së tyre si edhe ofrojnë hapësirën e duhur dhe të përshtatshme për moshën, që fëmijët të shprehin lirisht mendimin e tyre.
- 4.21 OSHMA-të mundësojnë programe dhe rubrika për fëmijë, të përgatitura edhe nga vetë fëmijët ose në bashkëpunim me ta.
- 4.22 OSHMA-të krijojnë mundësitë për realizimin e emisioneve ose programeve për fëmijë në gjuhët e minoriteteve etnike dhe kulturore, që jetojnë në Shqipëri.
- 4.23 OSHMA-të inkurajohen të ofrojnë informacion të nevojshëm për parandalimin e formave të ndryshme të shfrytëzimit/abuzimit seksual të fëmijëve, dhunës ndaj fëmijës, trafikimit dhe rreziqeve të tjera për fëmijët, duke respektuar të drejtat e fëmijës dhe interesin më të lartë të tij.

Ndalimi i identifikimit të fëmijës

- 4.24 OSHMA-ve u ndalohet raportimi, transmetimi ose shpërndarja e çdo të dhëne që çon drejtpërdrejtë ose në mënyrë të tërthortë në identifikimin me pamje dhe zë, me gjeneralitete, adresë ose përshkrim të fëmijës, që është ose mund të jetë viktimë apo dëshmitar në një ngjarje familjare ose në mjedise të tjera, i hetuar, i akuzuar ose i deklaruar fajtor për kryerjen e një vepre penale, me përjashtim të rasteve të parashikuara në legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.
- 4.25 OSHMA-të shmangin çdo raportim me identifikim të fëmijës, që mund të jetë përfshirë në një ngjarje të rëndë, veçanërisht, por jo vetëm në: largim nga familja, tentativë për vetëvrasje, trafikim ose rrezik trafikimi, shfrytëzim ose përdorim nga grupet kriminale, përfshirje në prostitucion ose veprimtari të paligjshme, arrestim apo dënim prindërisht ose familjarësh të tjerë, prani si dëshmitarë dhune në familje ose në shoqëri, etj.
- 4.26 Në rastet e parashikuara në pikat 4.24 dhe 4.25 më sipër, OSHMA-të përdorin teknologji të përshtatshme mbulimi për fshehjen e identitetit me pamje dhe zë të fëmijës, si edhe shmangin detajet që mundësojnë identifikimin e tërthortë të tij. Në rastet kur kjo përligjet nga interesi më i lartë i fëmijës, pyetja e fëmijës kryhet në prani të psikologut.
- 4.27 Ndalohet transmetimi i pamjeve të fëmijëve, të marra në mënyrë të fshehtë. Ato merren në mënyrë të ndershme dhe përdoren vetëm për qëllimin e shpjeguar. OSHMA-të mund të marrin pamje të fëmijës vetëm me dijeninë dhe pëlqimin e fëmijës dhe të prindit/ëve të tij ose kujdestarit ligjor të fëmijës, pasi të jetë shpjeguar qëllimi dhe mënyra e përdorimit të tyre. Nëse fëmija nuk pranon, pëlqimi i prindit ose kujdestarit të tij nuk mjafton.

- 4.28 OSHMA-të dhe PSHV-të shmangin çdo transmetim të pamjeve degraduese ose poshtëruese të fëmijës për çfarëdolloj qëllimi. OSHMA-ve dhe PSHV-ve u ndalohet transmetimi i pamjeve të fëmijëve me natyrë seksuale ose paraqitja e fëmijës në pozicione dhe veshje të papërshtatshme.
- 4.29 OSHMA-të, gjatë publikimit të ngjarjeve, raportimit për të drejtat e fëmijëve në konflikt me ligjin, marrjes së informacionit lidhur me kushtet në institucionet ku mbahen fëmijët në konflikt me ligjin, duhet të respektojnë privatësinë dhe të drejtat e tjera të fëmijës së dënuar.
- 4.30 OSHMA-të shmangin stereotipet negative dhe stigmatizimin e fëmijës me prindër të dënuar.
- 4.31 Të dhënat personale të fëmijëve të mbledhura ose të gjeneruara nga ofruesit e shërbimeve mediatike audio dhe audiovizive, si dhe nga platformat e shpërndarjes së videove nuk përpunohen për qëllime tregtare, të tilla, si: marketingu i drejtpërdrejtë, profilizimi dhe reklamimi mbi bazë sjellje apo për çdo lloj arsye tjetër.
- 4.32 OSHMA-të dhe PSHV-të miratojnë dhe zbatojnë rregulla të qarta dhe të detajuara për mbledhjen, përpunimin, arkivimin, përdorimin dhe shpërndarjen e materialeve dhe filmimeve me fëmijë, duke parandaluar dhe ndaluar mundësitë e keqpërdorimit të tyre.

Intervistimi i fëmijës

- 4.33 OSHMA-të intervistojnë fëmijën nën moshën 14 vjeç në prani të prindit, përfaqësuesit ligjor ose të një personi të caktuar madhor, si edhe me pëlqimin e fëmijës.
- 4.34 Para intervistimit, fëmijës dhe përfaqësuesit ligjor i shpjegohet paraprakisht qëllimi i intervistës. Në çdo rast respektohet e drejta e fëmijës dhe përfaqësuesit ligjor për të refuzuar intervistimin. Nëse fëmija nuk pranon, intervista nuk kryhet.
- 4.35 Në rast se përfaqësuesi ligjor refuzon intervistimin e fëmijës dhe fëmija shpreh pëlqimin të intervistohet, intervista kryhet në prani të psikologut, punonjësit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, mësuesit të shkollës ose edukatorit, kur intervistimi është në interesin më të lartë të fëmijës.
- 4.36 Ndalohet çdo premtim, dhuratë ose presion ndaj fëmijës ose përfaqësuesit të tij ligjor, me qëllim mundësimin e intervistimit.
- 4.37 Nëse është e nevojshme, gjatë intervistimit të fëmijës, krahas përfaqësuesit ligjor, gazetari mund të kërkojë asistencën e një psikologu ose punonjësi social të specializuar.
- 4.38 Intervistimi i fëmijës zhvillohet në një mjedis të përshtatshëm dhe miqësor për të. Intervistat dhe filmimet, që lodhin dhe ndikojnë negativisht te fëmija si edhe përsëritja e tyre e paarsyetuar me të njëjtën fëmijë, duhen të shmangen.

- 4.39 Pyetjet e drejtuara fëmijës duhet të jenë të qarta, të drejtpërdrejta dhe të mos i sugjerojnë fëmijës përgjigjen. Gjatë intervistimit, duhet të shmangen pyetjet ose komentet paragjyquese, që dëmtojnë fëmijën ose që i risjellin ndërmend ngjarjet e rënda për të.
- 4.40 Nëse gjatë intervistimit, gazetari vihet në dijeni për një vepër penale të kryer ndaj fëmijës ose që e rrezikon atë, gazetari vetë dhe OSHMA-ja njoftojnë menjëherë organet përkatëse.
- 4.41 Në rast se gjatë intervistimit, gazetari vihet në dijeni për fakte, publikimi i të cilave mund të rrezikojë jetën, shëndetin, mirëqenien fizike, emocionale, morale dhe arsimimin e fëmijës, intervista ose pjesë të saj nuk transmetohen.
- 4.42** OSHMA-të shmangin intervistimin e fëmijëve - viktimë të abuzimit seksual dhe të formave të tjera të abuzimit, përveç rastit kur transmetimi i intervistës përputhet me interesin më të lartë të fëmijës dhe njëkohësisht ka interes publik. Në çdo rast, gjatë transmetimit të intervistës përdoret teknika e posaçme e mbulimit të identitetit, nuk publikohen inicialet e emrit dhe të mbiemrit si edhe të dhëna dhe rrethana të tjera, që tërthorazi mund të identifikojnë fëmijën.

Reklamat dhe fëmijët

- 4.43 OSHMA-të nuk duhet të transmetojnë reklama që mund të dëmtojnë zhvillimin fizik, mendor ose moral të fëmijëve. OSHMA-të nuk duhet të transmetojnë dhe PSHV-të nuk duhet të shpërndajnë reklama të shërbimeve dhe produkteve, që paraqesin rrezik për zhvillimin fizik, mendor dhe moral të fëmijëve.
- 4.44 OSHMA-të nuk duhet të transmetojnë dhe PSHV-të nuk duhet të shpërndajnë asnjë formë reklame të pijeve alkoolike, pijeve energjike dhe pijeve të gazuara, që përmbajnë sheqer të shtuar, të cilat u drejtohen fëmijëve ose ku fëmijët janë pjesëmarrës. Produktet e ndaluara për reklamim janë të përcaktuara në aktet nënligjore në fuqi.
- 4.45 OSHMA-ve u ndalohet transmetimi i reklamave për pijet alkoolike, pijet energjike dhe pijet e gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar në brendësi të një programi drejtuar fëmijëve si dhe 60 minuta para dhe pas këtij programi.
- 4.46 Reklamat nuk duhet të paraqesin fëmijë, ose të rritur në prani të fëmijëve duke konsumuar pije alkoolike, produkte të ndryshme të duhanit, përfshirë cigaret elektrike, shishat, pijet energjike, pijet e gazuara me sheqer të shtuar, produktet ushqimore ose substancat e tjera të dëmshme për fëmijët
- 4.47 OSHMA-të nuk transmetojnë reklama, që u drejtohen fëmijëve për të nxitur drejtpërdrejt blerjen e mallrave ose shërbimeve ose/dhe për të bindur prindërit ose persona të tjerë të rritur, të blejnë këto mallra apo shërbime.

- 4.48 Reklamimi i një shërbimi ose produkti nuk lejohet të krijojë perceptimin se mungesa e tij do ta vendosë fëmijën në pozita inferiore ose diskriminuese në raport me të tjerët.
- 4.49 OSHMA- të nuk kryejnë vendosje produkti në programet për fëmijë.
- 4.50 OSHMA-të ndalohen të reklamojnë me çfarëdolloj mjeti nxitjen, shitjen ose konsumin e prodhimeve zëvendësuese të qumështit të gjirit, të reklamojnë ose promovojnë produkte qumështi ose të ngjashme me qumështin, përgatitur industrialisht për t'u tregtuar për ushqimin e foshnjave dhe fëmijëve të vegjël si dhe çdo produkt tjetër industrial, që tregtohet për ushqimin e tyre.
- 4.51 Reklammat për fëmijët duhet të përmbajnë gjuhë miqësore për fëmijët dhe të përshtaten me nevojat e grupit të fëmijëve të cilëve u drejtohet reklama.
- 4.52 OSHMA-të inkurajohen të transmetojnë spote sensibilizuese në dobi të fëmijës, me synim promovimin e ushqyerjes me gji, nxitjen e ushqyerjes dhe jetesës së shëndetshme, pjesëmarrjen e fëmijës në diskutimin e problemeve me interes për të në fushën e arsimimit, kujdesit shëndetësor, edukimit të gjithanshëm, mjedisit, inovacionit, mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, mënyrës së adresimit të keqtrajtimit, abuzimit, shfrytëzimit si edhe parandalimin e rreziqeve për fëmijët.
- 4.53 OSHMA-të hartojnë dhe zbatojnë kode sjelljeje lidhur me komunikimet e papërshtatshme me natyrë tregtare që shoqërojnë programet për fëmijë, përkitazi ushqimeve dhe pijeve, që përmbajnë substanca të dëmshme ose të padobishme për shëndetin fizik të fëmijëve, si yndyrë, acide yndyrore,
- kripë, sodë apo sheqer, të cilat nuk përputhen me normat e një ushqyerje të shëndetshme për këtë moshë.
- 4.54 OSHMA-të kontrollojnë paraprakisht përmbajtjen e reklamave, promocionit të programeve dhe veçanërisht të reklamave me dhe për fëmijët, duke garantuar që çdo fëmijë ose imazh fëmije, i përdorur në to, të jetë i shoqëruar me lejen me shkrim të prindit ose përfaqësuesit ligjor të fëmijës. Për fëmijët e moshës mbi 14 vjeç merret edhe pëlqimi me shkrim i fëmijës.
- 4.55 OSHMA-të hartojnë rregulla të brendshme për formatin e dhënies se lejes me shkrim të prindit ose kujdestarit të fëmijës për rastet e përfshirjes së fëmijës në reklama.
- 4.56 Transmetimi i programeve për fëmijë mund të ndërpritet nga spote reklamash ose shitjesh të drejtpërdrejta jo më shpesh se çdo 30 minuta, nëse kohëzgjatja e programit është më shumë se 30 minuta.
- 4.57 Shërbimet e transmetimit audioviziv për fëmijë nuk mund të sponsorizohen nga shoqëri, persona ose sipërmarrje, veprimtaria kryesore e të cilave është prodhimi ose tregtimi i cigareve ose prodhimeve të tjera të duhanit

4.58 Gjatë transmetimit të programeve për fëmijë ndalohet shfaqja e shenjave të sponsorizimit.

Programet kulturore, argëtuese, edukuese, filmat dhe fëmijët

- 4.59 OSHMA-të nuk transmetojnë programe dhe PSHV-të nuk ndajnë materiale që mund të dëmtojnë seriozisht zhvillimin fizik, mendor ose moral të fëmijëve, në veçanti përmbajtje audiovizive dhe materiale që përmbajnë pornografi ose/dhe skena dhune të skajshme.
- 4.60 OSHMA-të kujdesen të mos lëndojnë ndjeshmëritë e publikut me standardin e etikës së komunikimit, përfshirë komunikimin e dhunshëm dhe seksist ose paraqitjen provokuese të drejtuesve dhe pjesëmarrësve të programeve muzikore, kulturore, argëtuese dhe edukuese për shkak të modelit, që ata ofrojnë për publikun dhe efektin e tyre në zhvillimin moral, mendor e fizik të fëmijëve.
- 4.61 OSHMA-të planifikojnë orare të përshtatshme për programe edukative, kulturore dhe argëtuese për fëmijët dhe me fëmijët. OSHMA inkurajohen të shtojnë programet edukative me fëmijë dhe drejtuar fëmijëve, duke nxitur modelet pozitive të edukimit.
- 4.62 OSHMA-të zbatojnë me përpikëri kërkesat etiko-morale dhe mbrojnë të drejtat e fëmijëve në programet edukuese, kulturore argëtuese për fëmijët dhe me fëmijët. Përmbajtja e programeve të tilla vlerësohet nga Bordi i Etikës, pranë OSHMA-së.
- 4.63 OSHMA-të tregojnë kujdes të veçantë për gjuhën dhe komunikimin etik në programet edukuese, argëtuese, të humorit, në spektaklet e organizuara me dhe për fëmijët, duke ndaluar veçanërisht bullizimin dhe/ose stigmatizimin e fëmijës për çfarëdolloj shkak.
- 4.64 OSHMA-të zbatojnë detyrimet ligjore lidhur me orarin e transmetimit të programeve që mund të dëmtojnë zhvillimin mendor, fizik ose moral të fëmijëve. Këto programe transmetohen në fashën kohore 22.00 - 06.00.
- 4.65 OSHMA-të mbajnë parasysh pasojat që mund të shkaktohen nga transmetimi i përmbajtjeve të dëmshme për fëmijët në programe investigative, programe bamirësie, programe ndërmjetësi ose programe, që adresojnë familje në nevojë, përfshirë fëmijët dhe/ose prindërit e tyre.
- 4.66 OSHMA-të janë të detyruara të vendosin shenjat paralajmëruese për mbrojtjen e fëmijëve, në çdo transmetim që përmban skena të dëmshme për fëmijën. Programet me përmbajtje të dëmshme për fëmijët paraprihen nga një paralajmërim akustik dhe shoqërohen nga prania e një simboli viziv gjatë gjithë kohëzgjatjes së tyre.
- 4.67 OSHMA-të duhet të mbajnë parasysh interesat e edukimit të fëmijës në transmetimet audio dhe audiovizive, duke u kujdesur të shmangin rrezikun e varësisë së fëmijës ndaj televizionit dhe shndërrimin e personazheve televizive në model imitimi për ta.

- 4.68 OSHMA-të, në rastin e shërbimeve mediatike audiovizive në bazë të kërkesës së përdoruesit, duhet të transmetojnë në formë të koduar programet që mund të dëmtojnë rëndë zhvillimin fizik, mendor ose moral të fëmijëve. OSHMA-të nuk lejohet të transmetojnë programe pornografike pa siguruar mbrojtjen e fëmijëve, nëpërmjet pajisjeve të aksesit të kushtëzuar dhe kontrollit prindëror.
- 4.68/1 PSHV-të shmangin publikimin e përmbajtjeve që mund të dëmtojnë rëndë zhvillimin fizik, mendor ose moral të fëmijëve. PSHV-të aplikojnë mjetet e aksesit të kushtëzuar dhe kontrollit moshor gjatë publikimit të përmbajtjeve me karakter pornografik.
- 4.69 OSHMA-të shmangin transmetimet me përmbajtje dhune, bullizmi, gjuhe urrejtjeje, me fjalor banal apo të papërshtatshëm, transmetimet e pakontrolluara dhe të dëmshme për fëmijët, përfshirë këngë dhe/ose video në oraret e aksesueshme nga fëmijët.
- 4.69/1 PSHV-të shmangin materialet me përmbajtje dhune, bullizmi, gjuhe urrejtjeje, me fjalor banal apo të papërshtatshëm, transmetimet e pakontrolluara dhe të dëmshme për fëmijët, përfshirë këngë dhe/ose video.
- 4.70 Në transmetimet e filmave, OSHMA-të duhet të zbatojnë kërkesat e ligjit nr. 8096, datë 21.03.1996 “Për Kinematografinë”, i ndryshuar, neni 11, lidhur me kufizimet moshore në distribuimin e veprës kinematografike.

Shenjat paralajmëruese për mbrojtjen e fëmijëve në programet audio dhe audiovizive

- 4.71 OSHMA-të detyrimisht përdorin shenja paralajmëruese për programet që transmetohen në fashën orare 06.00 – 22.00 dhe që mund të cenojnë ose dëmtojnë fëmijët.
- 4.72 OSHMA-të duhet të transmetojnë programet e përcaktuara në pikat 4.65 dhe 4.66, me shenjën përkatëse, e cila duhet të shfaqet në ekran, në një vend të dukshëm, me ngjyrë të qartë e të dallueshme.
- 4.73 OSHMA-të duhet të përgatisin transmetimin e filmave ose programeve të përcaktuara në pikën 4.69 me shenjën përkatëse (kur programi vetë nuk e përcakton), duke u mbështetur në vizionimin paraprak të programit, sipas kritereve, standardeve e rregullave të Kodit të Transmetimit.
- 4.74 Shfaqja e shenjës paralajmëruese në ekran bëhet menjëherë me fillimin e programit ose filmit dhe e shoqëron atë gjatë gjithë kohës së transmetimit. Shenja paralajmëruese rishfaqet para dhe pas të gjitha ndërprerjeve të programit në vijim, deri në përfundim të tij.
- 4.75 Llojet e shenjave paralajmëruese, që përdoren nga OSHMA-të do të jenë tri:

- Shenjë paralajmëruese me *ngjyrë të kuqe*, për përmbajtje që transmetohen vetëm pas orës 22.00, me skena të rënda dhune psikologjike e fizike, seksuale, me keqpërdorim të gjuhës, fjalorit dhe etikës së komunikimit.
- Shenjë paralajmëruese me *ngjyrë portokalli* për përmbajtje, të cilat fëmijët duhet t'i ndjekin të shoqëruar nga të rriturit.
- Shenjë paralajmëruese me *ngjyrë të gjelbër*, për përmbajtje që mund të ndiqen nga të gjithë, përfshirë edhe fëmijët.

4.76 OSHMA-të mund të përdorin forma të ndryshme të zgjidhjes grafike për shenjat paralajmëruese, por ngjyra dhe qartësia e shenjës janë elementë të pandryshueshëm dhe të detyrueshëm për të gjithë.

SEKSIONI 5

PARANDALIMI E LUFTIMI I DISKRIMINIMIT GJINOR DHE PROMOVIMI I BARAZISË GJINORE

- 5.1 OSHMA-të dhe PSHV-të garantojnë respektimin e dinjitetit njerëzor dhe ndalojnë çdo diskriminim dhe dhunim me bazë gjinore në çfarëdo formë të shprehjes së tyre në to.
- 5.2 OSHMA-ve dhe PSHV-ve u ndalohet të përdorin gjuhë urrejtjeje mbi baza seksiste në të gjitha programet, përfshirë edhe reklamat si dhe të promovojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi diskriminimin me bazë gjinore.
- 5.3 OSHMA-të nuk transmetojnë reklama me pamje, role dhe paraqitje stereotipike të grave apo/dhe burrave ose me gjuhë dhe përmbajtje seksiste, të cilat provokojnë diskriminim për shkak të gjinisë, nxitje të urrejtjes ose/dhe dhunës me bazë gjinore.
- 5.4 OSHMA-të nuk favorizojnë objektivizimin seksual apo përshkrimin e seksualizuar të grave, burrave, vajzave dhe djemve si edhe raportimet nënçmuese ose banalizuese për pamjen, veshjen dhe sjelljen e grave dhe vajzave.
- 5.5 OSHMA-të angazhohen, që nëpërmjet programacionit të tyre, të sensibilizojnë opinionin publik për luftimin e diskriminimit me bazë gjinore. Ato shmangin në transmetimet e tyre cenimin e privatësisë së viktimave të dhunës me bazë gjinore si edhe çdo shkelje tjetër të të drejtave të grave dhe fëmijëve të tyre.
- 5.6 OSHMA-të inkurajohen të zhvillojnë politika më të gjera të barazisë, diversitetit dhe përfshirjes.

- 5.7 OSHMA-të përpiqen për një prani të balancuar të gjinive në transmetimet e tyre. OSHMA-të promovojnë përfaqësimin e ekuilibruar gjinor veçanërisht në programet me ndjeshmëri gjinore dhe fokus diskriminimin e shumëfishtë prej grupeve shoqërore më të cenueshme në shoqëri.
- 5.8 OSHMA-të angazhohen për pasqyrimin e balancuar, gjithëpërfshirës dhe të mirinformuar të pikëpamjeve të opinionit të gjerë me synim shmangien e stereotipeve gjinore në mënyrën e adresimit të dhunës me bazë gjinore si edhe të marrëdhënieve familjare, shoqërore dhe riprodhuese.
- 5.9 OSHMA-të inkurajohen të bashkëpunojnë me institucionet e barazisë, organizatat e medias dhe të shoqërisë civile dhe institucionet e specializuara në fushën e barazisë gjinore, për të promovuar portretizimin jostereotipik të gjinive në media dhe në reklama si edhe për të promovuar komunikimin me ndjeshmëri gjinore.
- 5.10 OSHMA-të inkurajohen të hartojnë, miratojnë dhe zbatojnë politika dhe mekanizma vetërregullues për eliminimin e seksizmit, përfshirë gjuhën e urrejtjes seksiste në transmetimet audio dhe audiovizive, përfshirë reklamat dhe në sektorë të tjerë të punës së tyre, duke u mbështetur në standarde ndërkombëtare të gjithëpranuara, si treguesit e raportimit me ndjeshmëri gjinore të UNESCO-s, Udhëzimet e Këshillit të Evropës dhe të OSBE-së.

SEKSIONI 6

TË DREJTAT DHE AKSESI I PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

- 6.1 OSHMA-të marrin masa që personat me aftësi të kufizuara të kenë akses në përmbajtjen e transmetimeve audio dhe audiovizive, shërbimeve, pajisjeve, sistemeve dhe aplikacioneve të ofruara për publikun, në platformat dhe teknologjinë, përmes të cilave ai ofrohet.
- 6.2 OSHMA-të marrin masa që programet e transmetuara prej tyre të bëhen gradualisht dhe në mënyrë progresive të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara dëgjimi dhe shikimi, përmes interpretimit në gjuhën e shenjave, titrimin, përshkrimin me zë të titrave, duke filluar nga transmetimet në kohën e shikueshmërisë maksimale, edicionet informative dhe programet me interes të veçantë për personat me aftësi të kufizuara dëgjimi dhe shikimi.
- 6.3 OSHMA-të kombëtare përdorin gjuhën e shenjave ose titrimin në të paktën një prej edicioneve kryesore të lajmeve çdo ditë, me qëllim garantimin e të drejtës së informimit për personat me aftësi të kufizuara dëgjimi dhe shikimi.
- 6.4 OSHMA-të sigurojnë që veçanërisht informacioni në rast emergjencash, përfshirë komunikimet publike dhe njoftimet në rast fatkeqësish natyrore, të ofrohet në mënyrë të tillë, që të jetë i aksesueshëm nga personat me aftësi të kufizuara, përfshirë personat me aftësi të kufizuara dëgjimi dhe shikimi.

- 6.5 OSHMA-të bashkëpunojnë me organizatat e personave me aftësisë së kufizuara për të përcaktuar prioritetet e aksesimit të programacionit nga personat me aftësi të kufizuara dëgjimi dhe shikimi, si: emisionet informative, informimi për situatat e emergjencës dhe fatkeqësitë natyrore, transmetimet e drejtpërdrejta për zhvillimet me rëndësi në jetën politike, ekonomike dhe shoqërore të vendit, filmat, programet argëtuese, etj.
- 6.6 OSHMA-të informojnë personat me aftësi të kufizuara dëgjimi dhe shikimi mbi programacionin e aksesueshëm për ta dhe mundësojnë udhëzues për këtë qëllim.
- 6.7 AMA inkurajon OSHMA-të që të bashkëpunojnë me kompanitë, që ofrojnë pajisje që u mundësojnë përdoruesve me aftësi të kufizuara marrjen, dekodimin dhe shfaqjen e shërbimeve të aksesueshme.
- 6.8 OSHMA-të gjatë transmetimeve audio dhe audiovizive si dhe PSHV-të nuk duhet të paragjykojnë, të përdorin ose të identifikojnë personat me aftësi të kufizuara, për të mbrojtur të drejtat dhe për të mos dëmtuar interesat e tyre.
- 6.9 OSHMA-të duhet t'i trajtojnë me etikë dhe kujdes maksimal pamjet e personave me aftësi të kufizuara. Aftësia e kufizuar nuk duhet të paraqitet me detaje dhe gjuha e komunikimit e gazetarëve duhet të respektojë dinjitetin e tyre.
- 6.10 OSHMA-të kanë për detyrë të informojnë publikun për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, të tërheqin vëmendjen dhe të sensibilizojnë shoqërinë dhe institucionet për përgjegjësitë ndaj personave me aftësi të kufizuara.
- 6.11 OSHMA-të inkurajohen të promovojnë përpjekjet e shoqatave dhe personave me aftësi të kufizuara për integrimin e tyre në jetën shoqërore.
- 6.12 OSHMA-të duhet të sigurojnë trajtim të drejtë dhe objektiv të personave me aftësi të kufizuara në programet e tyre. OSHMA-të, përputhur me programacionin e tyre, vlerësojnë, inkurajojnë dhe promovojnë modelet pozitive të personave me aftësi të kufizuara.
- 6.13 OSHMA-të dhe PSHV-të nuk duhet të lejojnë përdorimin e imazhit të personave me aftësi të kufizuara për qëllime publiciteti ose reklame, me përjashtim të rasteve, kur kjo bëhet në interes të sensibilizimit të komunitetit për respektimin dhe/ose promovimin e të drejtave të tyre.
- 6.14 OSHMA-të dhe PSHV-të nuk duhet të shfrytëzojnë ndjeshmërinë e publikut ndaj personave me aftësi të kufizuara për përfitime ose qëllime komerciale.
- 6.15 OSHMA-të nxiten, që, në bashkëpunim me organizatat që përfaqësojnë personat me aftësi të kufizuara dëgjimi dhe shikimi, të hartojnë plane të aksesueshmërisë progresive të tyre në transmetimet audio dhe audiovizive.

6.16 OSHMA-të informojnë periodikisht AMA-n për masat e marra me qëllim përmbushjen e detyrimeve ligjore, që programet e transmetuara prej tyre të jenë në mënyrë graduale dhe progresive të aksesueshme nga personat me aftësi të kufizuara dëgjimi dhe shikimi si dhe për planet e veprimit, të hartuara në këtë fushë.

SEKSIONI 7

PARANDALIMI DHE LUFTIMI I GJUHËS SË URREJTJES

- 7.1 OSHMA-të dhe PSHV-të respektojnë dhe promovojnë diversitetin, dialogun, respektin e ndërsjellë dhe mirëkuptimin mbarëshoqëror.
- 7.2 Materiali që përmban gjuhë urrejtjeje nuk përfshihet në programet audio dhe audiovizive si dhe në platformat e shpërndarjes së videove. Rastet përjashtimore përcaktohen prej kontekstit profesional.
- 7.3 Materiali që përmban trajtim abuziv ose poshtëruës të individëve, grupeve, feve ose komuniteteve, nuk duhet të përfshihet në programet audio dhe audiovizive si dhe në platformat e shpërndarjes së videove. Rastet përjashtimore përcaktohen prej kontekstit profesional.
- 7.4 Gazetarët dhe drejtuesit e programeve audio dhe audiovizive, të prodhuara nga OSHMA-të, nuk duhet të përfshihen në retorika, që fyejnë ose denigrojnë individë për shkak të gjinisë, moshës, racës, ngjyrës, gjuhës, besimit fetar, origjinës kombëtare ose etnike, aftësisë së kufizuar, identitetit gjinor ose orientimit seksual.
- 7.5 Gazetarët dhe drejtuesit e programeve audio dhe audiovizive, të prodhuara nga OSHMA-të, kundërshtojnë dhe hedhin poshtë retorikën e të ftuarve apo pjesëmarrësve, që fyejnë ose denigrojnë individë të ftuar apo pjesëmarrës sipas karakteristikave të përshkruara në paragrafin 7.4.
- 7.6 Karakteristikat personale të përshkruara në paragrafin 7.4 të individëve ose grupeve që janë objekt i raporteve ose programeve të lajmeve përmenden vetëm nëse ato i shërbejnë interesit publik.
- 7.7 OSHMA-të, në kuadrin e ofrimit të informacionit të saktë dhe të besueshëm, shmangin përshkrimin stereotip dhe poshtëruës të individëve, grupeve dhe komuniteteve dhe u japin zë grupeve dhe komuniteteve të ndryshme shoqërore, veçanërisht kur raportohet për çështje me interes të veçantë publik.
- 7.8 OSHMA-të shmangin identifikimin e kombësisë, fesë, etnisë, nëse nuk është e nevojshme dhe rëndësishme në një raportim ose gjatë transmetimit të programeve audio dhe audiovizive.

Gjatë veprimtarisë së tyre informative shmanget përdorimi i termave që mund të fyejnë ose ofendojnë një person të një besimi, shtetësie ose kombësie të caktuar.

- 7.9 OSHMA-të ndalojnë shpërdorimin e programeve audio dhe audiovizive dhe PSHV-të ndalojnë shpërdorimin e tyre nga personat që nxisin urrejtje, dhunë raciste, ksenofobe, homofobe/transfobe, radikaliste dhe ekstremiste, që promovojnë pikëpamje ekstremiste apo gjuhë urrejtjeje.
- 7.10 OSHMA-të parandalojnë dhe ndalojnë stereotipizimin negativ dhe stigmatizimin e grupeve shoqërore të caktuara.
- 7.11 OSHMA-të nuk transmetojnë dhe PSHV-të nuk shpërndajnë pamje të dhunshme ose veprimtari ku bëhet thirrje për dhunë ekstreme, radikalizëm, etj.
- 7.12 OSHMA-të inkurajojnë dhe transmetojnë reagimin e shpejtë të figurave publike dhe veçanërisht të udhëheqësve politikë, fetarë dhe komunitarë përballë gjuhës së urrejtjes, jo vetëm për ta dënuar, por edhe për ta orientuar atë drejt forcimit të vlerave, që gjuha e urrejtjes kërcënon.
- 7.13 OSHMA-të promovojnë veprimet për të luftuar përdorimin e gjuhës së urrejtjes dhe kontestuar natyrën e papranueshme të saj, duke respektuar lirinë e shprehjes dhe mendimit.
- 7.14 OSHMA-të dhe PSHV-të të krijojnë mekanizmat vetërregullatorë, rishikojnë kodet e sjelljes dhe miratojnë ndryshimet e nevojshme për të adresuar parandalimi e gjuhës së urrejtjes gjatë zhvillimit të veprimtarisë së tyre.
- 7.15 AMA mbështet trajnimin e përshtatshëm të redaktorëve, gazetarëve dhe profesionistëve të tjerë të sektorit të medias audio dhe audiovizive lidhur me gjuhën e urrejtjes dhe mënyrat e shmangies së përdorimit të saj.
- 7.16 OSHMA-të mundësojnë kanale efektive të raportimit të gjuhës së urrejtjes dhe monitorojnë së brendshmi përdorimin dhe përhapjen e gjuhës së urrejtjes. Në rast të konstatimit të përdorimit të gjuhës së urrejtjes gjatë veprimtarisë audio/ audiovizive, ato duhet të reagojnë, ta dënojnë atë dhe të promovojnë vlerat dhe parimet.
- 7.17 OSHMA-të promovojnë dhe lehtësojnë funksionimin e mekanizmave të ankesës si edhe forcojnë standardet e brendshme në favor të gazetarisë etike.
- 7.17/1 PSHV-të promovojnë dhe lehtësojnë funksionimin e mekanizmave raportues si edhe forcojnë standardet e etike.

SEKSIONI 8

REKLAMAT NË TRANSMETIMET AUDIO DHE AUDIOVIZIVE DHE PLATFORMAT E SHPËRNDARJES SË VIDEOVE

- 8.1 Transmetimi i reklamave nga OSHMA-të duhet të mbajë parasysh kërkesat e legjislacionit në fuqi, veçanërisht për reklamat e ndaluara dhe reklamat e fshehura.
- 8.2 OSHMA-të dhe PSHV-të nuk duhet të pranojnë ose të transmetojnë reklama që nxisin diskriminimin për secilin nga motivet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi ose reklama që nuk respektojnë dinjitetin dhe të drejtat e njeriut.
- 8.3 OSHMA-ve u ndalohet të transmetojnë reklama, të cilat përmbajnë joshje apo ndikim të shikuesve në mënyrë të pandërgjegjshme dhe/ose teknika për sugjestionimin e tyre.
- 8.4 Reklammat nuk duhet të nxisin ose të shtyjnë fëmijët të blejnë ose të marrin prodhime ose shërbime, duke i nxitur drejtpërsëdrejti për të kërkuar nga prindërit ose personat e afërm t'u marrin mallrat ose shërbimet e reklamuar, ose të shfrytëzojnë pozitën e fëmijëve në raport me prindërit, mësuesit ose persona të tjerë të afërm të tyre.
- 8.5 Ndalohet reklama në median audio dhe audiovizive e lojërave të fatit në një mënyrë të përshtatur për fëmijë ose që i paraqet lojërat e fatit si zgjidhje të problemeve financiare.
- 8.6 OSHMA-të nuk duhet të transmetojnë në programet audio dhe audiovizive për fëmijë materialet promocionale lidhur me lojërat e fatit apo reklama që ofrojnë, mbështesin ose nxisin lojërat e fatit.
- 8.7 Reklammat në transmetimet audio dhe audiovizive për produktet farmaceutike ose produktet mjekësore, që jepen vetëm me recetën e mjekut, janë të ndaluara.
- 8.8 Reklammat në transmetimet audio dhe audiovizive për trajtimet mjekësore janë të ndaluara. Ndalohet që mjeku të bëjë reklamë të çfarëdo lloji, me përjashtim të rasteve, kur këto kanë qëllim sensibilizues, shkencor ose edukativ.
- 8.9 Ndërprerjet për komunikimet me natyrë tregtare në programe të ndryshme duhet të respektojnë kohën e përcaktuar për reklamë si edhe normat dhe kërkesat e etikës së komunikimit.
- 8.10 Ndalohen reklama dhe promovimi i produkteve të duhanit, (cigare, cigare elektronike dhe rimbushje) në transmetimet audio dhe audiovizive.

- 8.11 Ndalohet çdo lloj forme e reklamimit të produkteve të duhanit, përfshirë promovimin indirekt përmes ngjyrave, që përfaqësojnë logot e kompanive ose promovimin nëpërmjet vendosjes dhe ekspozimit të produkteve, që imitojnë paketimin e jashtëm të një produkti duhani.
- 8.12 Ndalohet, botimi për qëllime reklame ose promovimi i fotografive, vizatimeve etj., në të cilat shfaqen persona që pinë duhan si edhe i imazheve, që krijojnë përshtypje të gabuar te publiku për karakteristikat dhe efektet e produkteve të duhanit.
- 8.13 Ndalohet sponsorizimi i programeve audio dhe audiovizive nga shoqëri që kanë për objekt të veprimtarisë të tyre prodhimin, importimin ose tregtimin e produkteve të duhanit, edhe në rastet kur ky sponsorizim ka për qëllim promovimin apo reklamën e produkteve të duhanit.

SEKSIONI 9

DISPOZITA KALIMTARE

- 9.1 OSHMA-të hartojnë/përditësojnë Kodin e Sjelljes Brenda 12 muajve nga miratimi i Kodi të Transmetimit.
- 9.2 OSHMA-të, në zbatim të nenit 42 të legjislacionit në fuqi për median audio dhe audiovizive dhe paragrafëve 4.19 dhe 4.54 të këtij Kodi, hartojnë/rishikojnë kodet e Sjelljes dhe miratojnë standardet e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve-viktima në transmetimet audio dhe audiovizive dhe formatin e dhënies së lejes për përfshirjen e fëmijëve në reklama, brenda 12 muajve nga miratimi i këtij Kodi.

SEKSIONI 10

HYRJA NË FUQI DHE PUBLIKIMI

- 10.1 Kodi i Transmetimit hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Autoriteti i Mediave Audiovizive.
- 10.2 Kodi i Transmetimit i miratuar me vendimin e AMA-s nr.228, datë 11.12.2017 shfuqizohet.
- 10.3 Kodi i Transmetimit publikohet menjëherë nga Autoriteti i Mediave Audiovizive në faqen e tij zyrtare në internet.